

VENDIM
Nr.1043, datë 14.10.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GOLEM, TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Golem, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Golem, të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.66, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Golem të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Golem për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Golem

Lidhje nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
15	Prona që përdoren për realizimin e funksionit në fushën administrative.	Në pronësi
16-30, 64,65	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
31	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
54-63	Varrezat publike	Në pronësi
66	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
68-663, 665-672	Infrastrukturë (Rrugë vendore)	Në pronësi
676-677	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
696-699,701-702,704,705,707,708,710,712-715,717-720,722-725,727,729,731	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
700,703,706,709,711,716,721,726,728,733,736,738,741,742,745,747,749,752,755,761,764,767,770	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi